



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omaladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports

Departamenti i Kulturës / Departman za Kulturu / Department of Culture

Në pajtim me Rregulloren Nr. 06/2015 për Çmim Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore “Azem Shkreli” dhe për Çmimet Vjetore për Letërsi, si dhe Rregullores Nr. 07/2017 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 06/2015 për Çmim Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore “Azem Shkreli” dhe për Çmimet Vjetore për Letërsi, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, publikon këtë:

SHPLLJE PUBLIKE

Propozimet për Çmimin Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore “Azem Shkreli”, dhe për Çmimet e tjera për Letërsi, bëhen përmes nominimit nga:

- 1) Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës;
- 2) Instituti Albanologjik i Prishtinës;
- 3) Biblioteka Kombëtare e Kosovës;
- 4) Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Prishtinës;
- 5) Shtëpitë botuese të Kosovës;
- 6) Redaksitë e gazetave dhe revistave letrare-kulturore të Kosovës;
- 7) Asociacionet e shkrimtarëve që veprojnë brenda territorit të Kosovës;
- 8) OJQ-të që merren me veprimtari kulturore në Kosovë;
- 9) Personalitetet me reputacion publik, dhe
- 10) Autorët e veprave letrare.

Vlerësimin për ndarjen e çmimeve e bën juria profesionale e përbërë nga 5 anëtarë.
Propozimi me shkrim është i plotë dhe shqyrtohet vetëm nëse plotësohen këto kritere:

- a) Propozimi duhet të shoqërohet me arsyetimin ku paraqiten arritjet dhe meritat e veçanta, bashkë me CV-në krijuese të personit të propozuar.
- b) Propozimi duhet të firmoset nga subjekti që ka të drejtën e propozimit.
- c) Për çmimin vjetor të propozuar duhet të dorëzohen edhe 6 ekzemplarë të librit konkurrues.
- ç) Propozimet pa dokumentacion komplet nuk do të shqyrtohen.

Propozimi me shkrim duhet të dërgohet nga data: 05 Dhjetor 2017 deri më 05 Janar 2018, në Arkivin e MKRS-së, për Departamentin e Kulturës, në Zyrë nr. 022 (Adresa: MKRS, 10,000 Prishtinë, Rruga “Nëna Terezë” nr. 35).